

Të nderuar,

Gjatë vitit 2023 ishim dëshmitarë të zhvillimit të mëtejshëm të pasigurive lidhur me zhvillimet globale. Nga konfliktet ushtarake, përmes goditjeve të çmimeve, inflacionit global, politikave monetare të shtrënguara për përballimin e inflacionit, sfidat për të ruajtur likuiditetin dhe aftësinë paguese të bankave të mëdha të shkaktuara nga rritja e normave të interesit referencë, deri te fatkeqësitë natyrore me përmasa katastrofike, të cilat po lidhen gjithnjë e më shumë me ndryshimet klimatike globale.

Ekonomia e brendshme nuk është imune ndaj zhvillimit të pafavorshëm të rreziqeve nga mjedisi i jashtëm. Bartësit e politikave ekonomike në vend ishin kryesisht të përqendruar në parandalimin e rritjes së mëtejshme të çmimeve, mbi të gjitha të produkteve ushqimore bazë, mbrojtjen e popullsisë nga goditjet e çmimeve në anën e konsumit të energjisë elektrike, si dhe shtrëngimin e politikës monetare me qëllim uljen e presioneve inflacioniste. Efektet e politikës monetare janë në uljen dhe stabilizimin e caktuar të inflacionit. Por, është e sigurt se rritja reale vjetore e PBB-së do të jetë rreth 1%, që është reflektim i ndikimit të zhvillimeve të pafavorshme globale në ekonominë e brendshme.<sup>1</sup>

Në kushte të tilla, sektori i sigurimeve vazhdoi të arrijë rezultate solide dhe të përballet me sfidat. Megjithëse pjesëmarrja relative e sektorit të sigurimeve në ndërmjetësimin financiar total të të gjitha institucioneve financiare, duke përfshirë kryesisht bankat dhe shoqëritë që menaxhojnë fondet e pensioneve, është ende e vogël, shoqëritë e sigurimeve kanë një rol të rëndësishëm në kryerjen e funksioneve sociale dhe mbrojtëse të zbutjes dhe amortizimit të pasojave të dëmshme negative të zhvillimit dhe shfaqjes së rreziqeve të siguruar. Prandaj, për të zbutur humbjet në të ardhmen, është e nevojshme që të gjithë të përpiqemi dhe të punojmë për edukimin dhe stimulimin sa më të madh të përfshirjes, për të rritur numrin e

sigurimeve, pasi do të kontribuonim më tej në rritjen e mëtejshme të rezistencës dhe mbrojtjes së pronës dhe personave nga zhvillimi gjithnjë e më i sigurt i mëtejshëm i pafavorshëm i rreziqeve në të ardhmen.

Ndryshime të mëdha në rregullore po ndodhin në tregun e vetëm evropian për shërbimet e sigurimit. Kërkesat për sigurime në kornizat globale po përjetojnë ndryshime strukturore. Nevojat për sigurim diktojnë ndryshime të rëndësishme në modelet e aplikuara të biznesit. Qëllimi përfundimtar i këtyre ndryshimeve është përshtatja më e lehtë dhe më e shpejtë e shoqërive në kushtet e ndryshimeve të përsheptuara teknologjike që lidhen me zhvillimin dhe përdorimin e inteligjencës artificiale, digjitalizimin, por edhe me ndikimin negativ të ndryshimeve klimatike. Arritja e qëllimit përfundimtar të mbrojtjes së policave dhe përfituesve të sigurimeve është shumë më tepër sesa mbikëqyrja e respektimit të rregulloreve që lidhen me ruajtjen e aftësisë paguese dhe gjendjes financiare të siguruesve. I njëjti synim i mbikëqyrësve tashmë arrihet gjithnjë e më shumë përmes masave rregullatore që nxisin rritjen e numrit të të siguruarve. Duke rritur numrin e rreziqeve të siguruar, duke zgjeruar mbulimin dhe duke përfshirë territoret gjeografike dhe popullsitë që janë të ekspozuara ndaj rreziqeve, dhe që historikisht ose nuk kanë qenë të siguruar, ose kanë qenë, por jo të mjaftueshme. Këto ndryshime nuk bëhen të izoluara, vetëm në sektorin e sigurimeve. Ato ndodhin kryesisht si rezultat i bashkëpunimit të forcuar ndërinstitucional të tregjeve të sigurimeve me pushtetin vendor, por edhe me rregullatorë të pavarur, institucione të arsimit të lartë dhe shkencor, organe profesionale të aktuarëve dhe menaxherëve të riskut, madje edhe me sektorin joqeveritar.

AMS-ja në vazhdimësi i monitoron këto zhvillime dhe i zbaton në mënyrë të duhur dhe transparente, merr iniciativa në funksionimin e saj dhe në përputhje me mandatin dhe kompetencat ligjore.

Më lejoni të listoj disa iniciativa në të cilat AMS-ja ka marrë pjesë aktive në vitin 2023.

Është shumë e rëndësishme puna e grupit të punës të ngritur në Ministrinë e Financave për ndryshimin e rregullores bazë ligjore të sigurimeve. Qëllimi i këtyre ndryshimeve rregullatore duhet të jetë pikërisht në funksion të krijimit të një mjedisi rregullator në të cilin shërbimet e sigurimit do të jenë në funksion të arritjes së këtyre synimeve të zhvillimit të qëndrueshëm. Më tej, në kuadër të komisionit dhe nënkomisioneve për stabilitet financiar, u krijua korniza bazë, procedurat, masat dhe instrumentet për ruajtjen e stabilitetit financiar në këtë sektor. Në segmentin e nxitjes së inovacionit dhe përdorimit të teknologjive në sektorin financiar, janë vendosur kuadri dhe fillimet e veprimit institucional. AMS-ja është fokusuar edhe në mbikëqyrjen e sistemeve IT të subjekteve nën mbikëqyrje për të reduktuar rreziqet e gabimeve, por edhe për të rritur nivelin e rezistencës së sistemeve. Në fushën e rritjes së edukimit financiar dhe sigurimit të një shkalle më të madhe të përfshirjes financiare, ne zbatojmë vazhdimisht aktivitete dhe veprime në mënyrë të integruar në nivele të shumta duke kryer mbikëqyrje, edukimin e të siguruarve dhe duke adresuar ankesat. Gjatë vitit 2023 vazhduam të organizojmë trajnime dhe provime për aktuarët e certifikuar sipas një programi të njohur ndërkombëtarisht. Me këtë presim përmirësim të mëtejshëm institucional të cilësisë së menaxhimit të riskut në sektorin e

sigurimeve, por edhe zhvillim të produkteve të reja sipas kërkesave dhe nevojave të popullatës dhe bizneseve.

Me vëmendje të veçantë monitorojmë veprimtarinë e shoqërive të sigurimit në segmentin e sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësive automobilistike (PA). Mbrojtja e palëve të treta, viktima të aksidenteve rrugore të shkaktuara nga mjetet motorike është fokusi i interesit tonë. Mënyra më e mirë e mbrojtjes është pagesa e shpejtë dhe e drejtë ndaj çdo personi që ka të drejtën e kompensimit. Jemi të vetëdijshëm për sfidën e madhe me të cilën përballemi lidhur me liberalizimin. Pritshmëritë dhe angazhimet tona janë që përmes këtij procesi të kalojmë në mënyrë transparente dhe në të njëjtën kohë të ruajmë stabilitetin financiar dhe aftësinë paguese të shoqërive të sigurimeve. Por nga ana tjetër presim përmirësim të mëtejshëm si në cilësinë e trajtimit të dëmit ashtu edhe në vlerën të pagesave për kërkesat për dëmet e shkaktuara nga përdorimi i mjeteve motorike.

Ju ftoj t'i lexoni me kujdes zhvillimet dhe të dhënat, si dhe treguesit e tregut të përfshirë në këtë raport vjetor.

Me respekt,

Kërste Shajnoski



---

AGJENCIA E MBIKËQYRJES SË SIGURIMEVE

RAPORT VJETOR  
MBI GJENDJEN DHE LËVIZJEN E TREGUT TË SIGURIMEVE NË VITIN 2023

Shkup, 2024

*Ky raport është përgatitur në përputhje me nenin 158-o të Ligjit për Mbikëqyrje të Sigurimeve. Për përgatitjen e tij Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve ka përdorur të dhëna nga raportet të cilat subjektet ia dorëzojnë Agjencisë në përputhje me kërkesat ligjore. Për saktësinë e të dhënave përgjigjen subjektet e mbikëqyrjes.*

# PËRMBAJTJA

<b>1. HYRJA</b>	<b>8</b>
<b>2. KUADRI LIGJOR</b>	<b>9</b>
<b>3. MJEDISI KOMBËTAR DHE NDËRKOMBËTAR</b>	<b>11</b>
<b>4. TREGU U SIGURIMEVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT</b>	<b>14</b>
<b>4.1. SHOQËRITË E SIGURIMEVE</b>	<b>14</b>
4.1.1. STRUKTURA E PRONËSISË	14
4.1.2. SHKALLA E ZHVILLIMIT	14
4.1.3. PRIMI I SHKRUAR BRUTO	17
4.1.4. STRUKTURA E PJESËMARRJES	21
4.1.5. DËMET E PAGUARA BRUTO	26
4.1.5.1. Ankesat nga të siguruarit	29
4.1.6. FONDET DHE BURIMET E FONDEVE	31
4.1.6.1. Struktura e fondeve	31
4.1.6.2. Struktura e burimeve të fondeve	33
4.1.7. PROVIGJONET TEKNIKE	36
4.1.8. FONDET ME TË CILAT MBULOHEN PROVIGJONET TEKNIKE	36
4.1.9. PËRSHTATSHMËRIA E KAPITALIT TË SHOQËRIVE TË SIGURIMIT	38
4.1.10. REZULTATI FINANCIAR NGA USHTRIMI I AKTIVITETIT	39
4.1.10.1. Rreziqet e sektorit të sigurimeve	40
4.1.11. TREGUESIT E SEKTORIT TË SIGURIMEVE	42
<b>4.2. NDËRMJETËSIMI NË SIGURIME</b>	<b>44</b>
4.2.1. PËRFAQËSIMI NË SIGURIME	45
4.2.2. VEPRIMTARI BROKERIMI NË SIGURIME	45
<b>4.3. BYROJA KOMBËTARE E SIGURIMEVE (BKS)</b>	<b>47</b>
4.3.1. FONDI GARANTUES I BKS-SË	47
4.3.2. RIMBURSIMI I DËMEVE NGA FONDI GARANTUES	48

## LISTA E TABELAVE

TABELA NR. 1: TREGUESIT MË TË RËNDËSISHËM PËR VENDET E EVROPËS QENDRORE DHE LINDORE NË VITIN 2022 .....	12
TABELA NR. 2: STRUKTURA E PRONËSISË SË SHOQËRIVE TË SIGURIMEVE .....	14
TABELA NR. 3: INDEKSI HERFINDAL DHE TREGUESI CR5 I MATUR SIPAS PBB .....	16
TABELA NR. 4: INDEKSI HERFINDAL DHE TREGUESI CR5 I MATUR SIPAS MJETEVE .....	16
TABELA NR. 5: PRIMI I SHKRUAR BRUTO SIPAS KLASAVE TË SIGURIMEVE (MIJË DENARË).....	17
TABELA NR. 6: PRIMI I SHKRUAR BRUTO SIPAS SHOQËRIVE TË SIGURIMIT JO-JETË (MIJË DENARË) .....	18
TABELA NR. 7: PRIMI I SHKRUAR BRUTO SIPAS SHOQËRIVE TË SIGURIMEVE TË JETËS (MIJË DENARË).....	19
TABELA NR. 8: PRIMI I SHKRUAR BRUTO PËR PERIUdhËN 01.01.2023 – 31.12.2023 (MIJË DENARË) .....	20
TABELA NR. 9: STRUKTURA E PBB PËR SIGURIM NA PA, NË MIJË DENARË .....	24
TABELA NR.10: PRIMI I SHKRUAR BRUTO PËR SIGURIM TË JETËS, NË MIJË DENARË.....	21
TABELA NR. 11: DËME TË PAGUARA SIPAS KLASAVE TË SIGURIMIT (MIJË DENARË).....	26
TABELA NR.12: STRUKTURA E DËMEVE TË PAGUARA BRUTO NGA PA, NË MIJË DENARË.....	24
TABELA NR. 13: NUMRI I DËMEVE TË PAGUARA .....	28
TABELA NR. 14: PARASHTRESA TË PARAQITURA NË SHOQËRITË E SIGURIMEVE NGA TË SIGURUARIT 2023 ...	29
TABELA NR. 15: PARASHTRESA TË PARAQITURA NË AMS NGA TË SIGURUARIT NË VITIN 2023 .....	30
TABELA NR. 16: STRUKTURA E MJETEVE TË SHOQËRIVE TË SIGURIMEVE JO-JETË.....	31
TABELA NR. 17: STRUKTURA E MJETEVE TË SHOQËRIVE TË SIGURIMEVE TË JETËS (MIJË DENARË) .....	29
TABELA NR. 18: STRUKTURA E BURIMEVE TË MJETEVE TË SHOQËRIVE TË SIGURIMEVE JO-JETË (NË MIJË DENARË).....	34
TABELA NR. 19: STRUKTURA E BURIMEVE TË MJETEVE TË SHOQËRIVE TË SIGURIMEVE TË JETËS (NË MIJË DENARË).....	34
TABELA NR. 20: KOEFICIENTËT TEKNIK .....	39
TABELA NR. 21: TREGUESIT FINANCIARË .....	44
TABELA NR. 22: STRUKTURA E KANALEVE TË SHITJES PËR POLICAT SIPAS PBB-SË SË REALIZUAR (NË MIJË DENARË).....	44
TABELA NR. 23: PJESËMARRJA NË FONDIN GARANTUES E SHOQËRIVE TË SIGURIMIT PËR PERIUdhËN 1.1.2023 – 31.12.2023 .....	48
TABELA NR. 24: DËME TË PARAQITURA DHE TË PRANUARA PËR RIMBURSIM NGA FONDI GARANTUES PËR PERIUdhËN 1.1.2023 – 31.12.2023 .....	49

## LISTA E GRAFIKËVE

GRAFIKU NR. 1: TREGUESIT E ZHVILLIMIT TË TREGUT TË SIGURIMEVE (MILIONA DENARË; BOSHTI I DJATHTË - PËRQINDJE) .....	15
GRAFIKU NR. 2: PËRQENDRIMI I TREGUT SIPAS PRIMIT TË SHKRUAR BRUTO NË VITIN 2023, NË GRUPIN E SIGURIMEVE JO-JETË (PËRQINDJE) .....	16
GRAFIKU NR. 3: PËRQENDRIMI I TREGUT SIPAS PRIMIT TË SHKRUAR BRUTO NË VITIN 2023, NË GRUPIN E SIGURIMEVE TË JETËS (PËRQINDJE) .....	16
GRAFIKU NR. 4: STRUKTURA E PRIMIT TË SHKRUAR BRUTO SIPAS KLASAVE TË SIGURIMIT (PËRQINDJE) .....	21
GRAFIKU NR. 5: TRENDI I PRIMIT TË SHKRUAR BRUTO SIPAS KLASAVE TË SIGURIMIT (MIJË DENARË; BOSHTI I DJATHTË - PËRQINDJE).....	23
GRAFIKU NR. 6: KONTRATA TË LIDHURA TE SHOQËRITË E SIGURIMEVE (BOSHTI I MAJTË – NDRYSHIMI VJETËR NË PËRQINDJE).....	26
GRAFIKU NR. 7: PJESËMARRJA E SHOQËRIVE TË SIGURIMIT NË DËMET E PAGUARA BRUTO NË VITIN 2023 (MIJË DENARË), VEÇ E VEÇ PËR JETË DHE JO-JETË .....	28
GRAFIKU NR. 8: STRUKTURA E ASETVE TË SHOQËRIVE TË SIGURIMIT MË DATË 31.12.2023, VEÇ E VEÇ PËR JETË DHE JO-JETË .....	33
GRAFIKU NR. 9: STRUKTURA E BURIMEVE TË MJETEVE, SHOQËRITË E SIGURIMIT – JO-JETË, NË MILIONA DENARË, MË 31.12.2023 .....	35
GRAFIKU NR. 10: STRUKTURA E BURIMEVE TË MJETEVE, SHOQËRITË E SIGURIMIT – JETË, NË MILIONA DENARË, MË 31.12.2023.....	35
GRAFIKU NR. 11: MBULIMI I REZERVAVE TEKNIKE NETO – SIGURIMI JO-JETË TEK SHOQËRITË E SIGURIMEVE (MILIONA DENARË; BOSHTI I DJATHTË – PËRQINDJE) .....	37

GRAFIKU NR. 12: MBULIMI I PROVIGJONEVE TEKNIKE NETO – TEK SHOQËRITË E SIGURIMIT TË JETËS (MILIONA DENARË; BOSHTI I DJATHTË - PËRQINDJE.....	37
GRAFIKU NR. 13: LËVIZJA E KAPITALIT DHE MARGJINA E NEVOJSHME E AFTËSISË PAGUESE TEK SHOQËRITË E SIGURIMEVE (MILIONA DENARË) .....	38
GRAFIKU NR. 14: STRUKTURA E KAPITALIT TË SHOQËRIVE TË SIGURIMIT (JETË DHE JO-JETË PËRKATËSISHT), NË MILIONA DENARË DHE NË PËRQINDJE TË KAPITALIT TOTAL.....	39
GRAFIKU NR. 15: REZULTATI FINANCIAR NGA VEPRIMTARIA E SHOQËRIVE TË SIGURIMEVE (MILIONA DENARË) .....	40
GRAFIKU NR. 16: STRUKTURA E PSHB, SIPAS KLASAVE TË SIGURIMIT .....	45
GRAFIKU NR. 17: STRUKTURA E PSHB, SIPAS KLASAVE TË SIGURIMIT .....	46

## 1. HYRJA

Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve (në tekstin e mëposhtëm "AMS") është një organ rregullator i pavarur dhe autonom në tregun e sigurimeve që ushtron kompetenca publike për të kontrolluar pajtueshmërinë e veprimtarisë së shoqërive të sigurimit dhe subjekteve të tjera në tregun e sigurimeve me rregulloret në fuqi me qëllim mbrojtjen e të siguruarve dhe përfituesve të sigurimit. AMS-ja është themeluar në vitin 2009, bazuar në ndryshimet e mëparshme të Ligjit për Mbikëqyrjen e Sigurimeve. Përveç kryerjes së mbikëqyrjes, si detyrë parësore, AMS-ja, së bashku me organet e tjera rregullatore të tregut financiar, vepron në mënyrë parandaluese dhe edukative në zbatimin e strategjive dhe planeve kombëtare për mbrojtjen më të mirë të të drejtave të të siguruarve dhe përdoruesve të tjerë të shërbimeve financiare për të ruajtur stabilitetin financiar në vend dhe për një përfshirje më të madhe në tregun e sigurimeve.

Gjatë vitit 2023 janë paraqitur dy kërkesa për themelimin e një shoqërie sigurimesh, një për shoqëri të sigurimit të jo-jetës dhe një për sigurimin e jetës. AMS-ja iu dha licencat dy shoqërive të reja të sigurimeve dhe njëra prej tyre filloi me punë në fund të vitit 2023, ndërsa tjetra në tremujorin e parë të vitit 2024. Me këtë, në sektorin e sigurimeve vendore tashmë janë 18 shoqëri sigurimesh, prej të cilave 12 merren me sigurime jo-jetë, dhe 6 me sigurime të jetës.

Në fushën e ndërmjetësimit, nga ana tjetër, në fund të vitit 2023 janë aktive 43 shoqëri brokerimi në sigurime, 12 shoqëri përfaqësimi sigurimesh dhe 8 banka që kryejnë punë përfaqësuese në sigurime.

Totali i Primit të shkruar bruto (në tekstin e mëposhtëm: "PSHB") në vitin 2023 është 14.344.690 mijë denarë, që paraqet rritje prej 12,2% krahasuar me PSHB-në e realizuar në vitin paraprak (2022: 12.785.429 mijë denarë). Në sektorin e sigurimit të jo-jetës, PSHB-ja është realizuar në vlerë prej 11,856,465 mijë denarësh (2022: 10,508,927 mijë denarë, gjegjësisht rritje prej 12,82% në krahasim me vitin 2022. Njëkohësisht, në sigurimin e jetës PSHB-ja është realizuar në vlerë prej 2,488,225 mijë denarësh (2022: 2,276,502 mijë denarë), që shënon një rritje prej 9,3%.

Më 31.12.2023, shoqëritë e sigurimeve kanë fonde në vlerë prej 33,880,219 mijë denarësh, të cilat janë rritur për 11,47% në krahasim me vitin e kaluar (2022: 30,393,398 mijë denarë). Kapitali i përgjithshëm<sup>2</sup> i llogaritur i shoqërive të sigurimit shënon rritje prej 15%<sup>3</sup> në krahasim me vitin 2022 dhe në fund të vitit 2023 arrin në 8.297.733 mijë denarë. Niveli i kërkuar i margjinës së aftësisë paguese, si tregues kryesor për vlerësimin e stabilitetit të sektorit të sigurimit, është agreguar në 2.274.968 mijë denarë, që do të thotë se kapitali i sektorit të sigurimit është 3,65 herë mbi nivelin e kërkuar të margjinës së aftësisë paguese.

Rentabiliteti i përgjithshëm është përmirësuar në krahasim me vitin e kaluar 2022, si në segmentet e tregut të jo-jetës ashtu edhe në atë të jetës. Gjatë vitit 2023, AMS-ja miratoi 5 rregullore të reja dhe një ndryshim në një akt nënligjor tashmë të vlefshëm.

---

<sup>2</sup> Sipas Ligjit për Mbikëqyrjen e Sigurimeve, kapitali i shoqërisë së sigurimit në një datë të caktuar llogaritet mund të ndryshojë nga shuma e kapitalit dhe rezervave të paraqitura në bilanc në të njëjtën datë.

<sup>3</sup> Në përllogaritjen e kapitalit të sektorit të sigurimeve me datë 31.12.2023 është përfshirë edhe gjendja e totalit të kapitalit themelues të paguar të shoqërisë së sigurimit të jetës që ka marrë licencën e punës në fund të vitit.



## 2. KUADRI LIGJOR

Ligji për Mbikëqyrjen e Sigurimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/02, 98/02, 79/07, 88/08, 67/10, 44/11, 112/11, 188/13, 30 /14, 43/14, 112/14, 153/15, 92/15, 23/16, 83/18 dhe 198/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 101/19, 31/20 dhe 173/22), Ligji për Sigurimin e Detyrueshëm në Transport ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 88/05, 70/06, 81/08, 47/11, 135/11, 112/14 dhe 145/ 15 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 220/19), Ligji për Sigurim Shëndetësor Vullnetar ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/12 dhe 192/15), Ligji për Pagim të Pensioneve dhe Kompensimeve Pensionale në Fushën e Sigurimit Pensional me Financim Kapital ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 11/12, 147/15 dhe 30/16), Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 185/11), Ligji për Stabilitet Financiar ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 173/22) dhe Ligji për Masat Kufizuese ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 190/17) janë kuadri ligjor bazë që rregullon kushtet dhe mënyrën e kryerjes së veprimtarisë së sigurimit dhe risigurimit, mënyrën dhe kushtet e kryerjes së veprimtarisë ndërmjetësuese në sigurime dhe zbatimin e mbikëqyrjes mbi veprimtarinë e shoqërive të sigurimit, shoqërive të brokerimit të sigurimeve dhe shoqërive të përfaqësimit të sigurimeve.

Korniza më e gjerë ligjore përfaqësohet nga Ligji për Marrëdhëniet e Obligative, në pjesën që ka të bëjë me kontratat e sigurimit dhe Ligji për Shoqëritë Tregtare.

**Ligji për Mbikëqyrje të Sigurimeve** i inkorporon parimet dhe standardet e sigurimeve të Asociacionit Ndërkombëtar të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS), si dhe direktivat për sigurime të Bashkimit Evropian (BE). Me këtë ligj normativizohet themelimi dhe veprimtaria e shoqërive të sigurimeve, menaxhimi me risqet, roli i aktuarëve të autorizuar, mbajtja e regjistrave të biznesit dhe raporteve, auditimi i brendshëm dhe i jashtëm, përfaqësimi dhe ndërmjetësimi në sigurimet, mbikëqyrja e shoqërive të sigurimeve, puna e AMS-së, zbatimi i mbikëqyrjes dhe procedurave për marrjen e aktvendimeve nga AMS-ja, bashkëpunimi me organet dhe trupat mbikëqyrëse të BE-së, si dhe dispozitat ndëshkuese apo kundërvajtëse.

Sigurimi i Detyrueshëm në Transport rregullohet me **Ligjin e Sigurimit të Detyrueshëm në Transport**, i cili i rregullon kontratat e sigurimit të detyrueshëm, shumat minimale të sigurimit, afatet e raportimit dhe kompensimit të dëmeve nga shoqëritë e sigurimeve, përcaktimin e së drejtës për ndërmjetësim (mediacion), kompetencat e Fondit të Garancisë, ndryshimin e mënyrës së përcaktimit të tarifave të primit përmes funksionimit të Komisionit të Sigurimit të Autopërgjegjësish dhe dispozitat ndëshkuese për shoqëritë e sigurimeve dhe Byronë Kombëtare të Sigurimeve. Gjithashtu, ligji përcakton detyrimet që shoqëritë e sigurimeve të caktojnë përfaqësues të autorizuar për dëmet jashtë vendit në mënyrë që viktimat e aksidenteve rrugore të kenë qasje të lehtë dhe të shpejtë në paraqitjen e kërkesave për dëmet e shkaktuara nga automjetet e vendit jashtë tij, si dhe të krijojnë një Shërbim për Kompensim të Dëmeve, si garanci për viktimat e aksidenteve rrugore jashtë vendit, ku edhe nëse shoferi përgjegjës drejtonte një automjet të pasiguar, dëmi do të trajtohet dhe paguhet në kohën e duhur. Disa nga këto dispozita tashmë kanë hyrë në fuqi, ndërsa disa të tjera do të hyjnë në fuqi nga momenti i anëtarësimit të plotë të Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian.

Me **Ligjin për Sigurim Vullnetar Shëndetësor** jepet mundësi ligjore dhe hapet një fushë e gjerë veprimi për shoqëritë e sigurimeve për oferta të pakove të shërbimeve shëndetësore të cilat janë përfshirë tashmë me sistemin e sigurimit të obligueshëm shëndetësor. Sigurimi shëndetësor vullnetar rregullohet si sigurim suplementar dhe sigurim shëndetësor privat. Sigurimi suplementar shëndetësor siguron mbulim të shpenzimeve në emër të pjesëmarrjes me mjete personale për

shfrytëzim të shërbimeve shëndetësore nga sigurimi i detyruar shëndetësor (participim), në përputhje me dispozitat e sigurimit të detyruar shëndetësor dhe mbrojtjes shëndetësore. Sigurimi privat shëndetësor mundëson mbulim të shpenzimeve për përdorim të shërbimeve shëndetësore për standard më të lartë të shërbimeve shëndetësore të cilat burojnë nga sigurimi i detyruar shëndetësor, shpenzimet për mbulim të shërbimeve shëndetësore të përdorura në veprimtari shtesë, si dhe për përdorim të shërbimeve shëndetësore në institucionet shëndetësore jashtë rrjetit të institucioneve shëndetësore ku kryhet veprimtaria shëndetësore dhe te personat juridikë të cilët kryejnë përpunim, dhënie dhe servisim të mjeteve ortopedike dhe mjeteve të tjera ndihmëse.

Me **Ligjin për Pagim të Pensioneve dhe Kompensimeve Pensionale nga Fusha e Sigurimit Pensional me Financim Kapital** përfundoi normativizimi i sigurimit kapital financiar në Republikën e Maqedonisë së Veriut me rregullim të fazës së deakumulimit, përkatësisht me këtë Ligj rregullohen pagesat e pensioneve nga shtylla e dytë dhe kompensimet e pensionit nga shtylla e tretë. Në ligj në mënyrë të hollësishme rregullohen llojet e pagesave të pensioneve në shtyllën e dytë (tërheqje të programuara, anuitete të përrjetshme dhe kombinimi i tyre), llojet e pagesave të kompensimeve të pensionit nga shtylla e tretë (tërheqje të programuara, anuitete, pagesa të njëfishta dhe të shumëfishta), karakteristika dhe rregulla për lloje të ndryshme të pagesave dhe mënyra dhe procedura e fitimit të së drejtës së pensionit në bazë të moshës, pension invalidi dhe pension familjar nga shtylla e dytë, si dhe procedurë për fitimin e së drejtës të kompensimit pensional nga shtylla e tretë. Në këtë Ligj rregullohet edhe se cilat institucione do të mund të bëjnë pagim të pensioneve dhe kompensimeve të pensioneve nga shtylla e dytë dhe e tretë - shoqëritë pensionale dhe shoqëritë për sigurim të jetës. Gjithashtu, për shkak të transparencës më të madhe të përzgjedhjes së pensionit nga shtylla e dytë dhe kompensimit të pensionit nga shtylla e tretë, u vendos Sistem elektronik i centralizuar i kotacionit nëpërmjet të cilit do të dorëzohen kërkesa për kotacione për lloje të ndryshme të pagesave dhe do të merren oferta nga shoqëritë pensionale dhe shoqëritë e sigurimeve.

**Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit** përcakton kompetencën e AMS-së për të zbatuar mbikëqyrje në tregun e sigurimeve i cili i nënshtrohet rregullimit të këtij Ligji, veçanërisht në pjesën e zbatimit të masave dhe veprimeve për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

**Ligji për Stabilitetin Financiar** rregullon qëllimet, statusin, detyrat dhe mënyrën e punës së Komisionit të Stabilitetit Financiar, si dhe instrumentet dhe mënyrën e zbatimit të politikës makroprudenciale kombëtare.

**Ligji për masat kufizuese** u cakton obligime shtesë subjekteve përgjegjëse për ndërmarrjen e masave për parandalimin e pastrimit të parave në drejtim të identifikimit dhe ndërmarrjes së veprimeve (masave financiare) ndaj personave për të cilët janë vendosur masa kufizuese nga BE-ja ose Kombet e Bashkuara. "Masat financiare" sipas nenit 5 të Ligjit për masat kufizuese përkufizohen si "ndalim i përdorimit, bartjes, konvertimit, transferimit ose lloj tjetër i disponimit të pronës, ndalim i vënies në disponim të çdo pasurie, drejtpërdrejt ose tërthorazi, si dhe ndalim i krijimit ose vazhdimin të marrëdhënieve afariste.

### 3. MJEDISI KOMBËTAR DHE NDËRKOMBËTAR

Sipas të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikave<sup>4</sup> dhe informacioneve<sup>5</sup> mujore të publikuara nga Banka Popullore, në vitin 2023 prodhimi real i brendshëm bruto (në tekstin e mëposhtëm “PBB”) vlerësohet të rritet me 2,1%. Kjo është një normë më e ulët e rritjes reale të PBB-së. Kjo është një normë më e ulët e rritjes reale të PBB-së sesa parashikimet e tetorit për rritje reale prej 1.9% në vitin 2023. Është evidente se ka një ngadalësim të rritjes reale vjetore krahasuar me dy vitet e mëparshme pas Covid-it, në të cilat PBB-ja u rrit me 2.1% dhe 3.9% respektivisht.

Norma vjetore e inflacionit vazhdon të ngadalësohet dhe arritjet në shkurt të vitit 2024 janë më të mira se sa pritej dhe gradualisht po i afrohen mesatares historike.

**Sistemi financiar i Republikës së Maqedonisë së Veriut** karakterizohet me një strukturë të thjeshtë relative. Sistemi bankar, e pastaj fondet e detyrueshme pensionale private dhe shoqëritë e sigurimeve, kanë pjesëmarrje më të lartë në asetet e sistemit financiar dhe pothuajse vazhdimisht kontribuojnë më së shumti për rritjen e tij absolute.

Vlera e përgjithshme e aseteve të të gjitha institucioneve financiare që veprojnë në tregun financiar në Maqedoni në fund të vitit 2022<sup>6</sup> është 866.069 milionë denarë, që paraqet 107,8% të PBB-së kombëtare.

Pjesëmarrja e sektorit të sigurimeve (shoqëritë e sigurimeve, shoqëritë e përfaqësimit të sigurimeve dhe shoqëritë e brokerimit të sigurimeve) në strukturën totale financiare në vitin 2022 është 3,85%<sup>7</sup>. Pavarësisht rritjes së vazhdueshme të sistemit financiar, një analizë krahasuese e niveleve të ndërmjetësimit financiar me vendet e tjera të Evropës Qendrore dhe Juglindore tregon për një madhësi modeste të sektorit financiar vendas. Segmentet më të mëdha dhe më të rëndësishme të sistemit financiar zotërohen kryesisht nga aksionerët e huaj. Struktura e pronësisë dhe përqendrimi në segmente të veçanta të sistemit financiar nuk shfaqin ndryshime të rëndësishme.

**Lidhshmëria ndërsektorale** e segmenteve të veçanta institucionale të sistemit financiar të Maqedonisë dhe mundësia për kalimin e rrezeve nga njëri segment në tjetrin janë në nivel të ulët. Arsytet për këtë janë struktura e thjeshtë e sistemit financiar, lidhshmëria e vogël e ndërsjellë e aktiviteteve të segmenteve të veçanta dhe mungesa e instrumenteve dhe shërbimeve më të ndërlikuara financiare. Stabiliteti i sistemit financiar është i kushtëzuar nga stabiliteti i sektorit bankar si segmenti i tij kryesor, ku janë përqendruar kursimet e sektorit jofinanciar dhe institucioneve të tjera financiare. Lidhshmëria e pronësisë ndërmjet institucioneve të veçanta nga sistemi financiar është në korniza mesatare dhe nuk paraqet burim varësie ndërmjet segmenteve të veçanta.<sup>8</sup>

Sigurimin bankar, përkatësisht bashkëpunimi ndërmjet bankave dhe shoqërive të sigurimit bazuar në marrëveshje përfaqësimi në sigurimin, në vitin 2023 e kanë aplikuar 8 banka (njëjtë si vitin paraprak) dhe është një shembull i lidhjes ndërsektorale.

<sup>4</sup> <https://www.stat.gov.mk/PrikaziSooopstenie.aspx?rbtxt=31>

<sup>5</sup> [https://www.nbrm.mk/content/MPI%20publikacii/Najnovi\\_makroekonomski\\_pokazатели\\_mart\\_2024.pdf](https://www.nbrm.mk/content/MPI%20publikacii/Najnovi_makroekonomski_pokazатели_mart_2024.pdf)

<sup>6</sup> Në momentin e përgatitjes së këtij raporti, Raporti i Stabilitetit Financiar për vitin 2023 ende nuk është publikuar.

<sup>7</sup> Raport për Stabilitetin Financiar për vitin 2022, Banka Popullore

<sup>8</sup> Raport për Stabilitetin Financiar për vitin 2022, Banka Popullore

Ekziston një lidhje e qenësishme midis sektorit të lizingut dhe sektorit të sigurimeve për shkak të detyrimit rregullator për të siguruar mjetin me lizing te ndonjë shoqëri sigurim (përveç nëse nuk është caktuar ndryshe në marrëveshjen e lizingut). Gjithashtu, oferta e a.q. produktet unit-linked të cilat paraqesin kombinim të sigurimit të jetës me investim në grup, përkatësisht sigurimit të jetës ku rrezikun e investimit e merr përsipër i siguruari, sugjerojnë për lidhshmërinë e këtij lloji të sigurimit me lëvizjet e tregjeve financiare, përkatësisht realizimet e fondeve investuese. Lidhja e pronësisë që ekziston ndërmjet institucioneve të veçanta financiare është një tjetër kanal potencial i ndërvarësisë dhe kalimit eventual të rreziqeve nga njëri segment i sistemit financiar në tjetrin.

Gjatë analizës dhe krahasimit të treguesve për shkallën e **zhvillimit të tregut vendor për sigurim me tregjet e rajonit** dhe më gjerë, mund të konkludohet se është në nivele përafërsisht të ngjashme me vendet e rajonit më të afërt, por larg nën nivelin e zhvillimit të mesatares së vendeve anëtare të Bashkimit Evropian. Nga 17 vende të Evropës Qendrore dhe Lindore, sipas treguesit të normës së depërtimit, Maqedonia është në vendin e 13-të për nga zhvillimi i tregut të sigurimeve (para Shqipërisë, Kosovës, Rumanisë dhe Estonisë), ndërsa sipas treguesit të normës së densitetit, ajo është në vendin e 15-të (para Shqipërisë dhe Kosovës).

Kjo, para së gjithash, është si rezultat i faktit që shoqëritë e sigurimeve te ne nuk janë përfshirë në fazën e akumulimit të fondeve nga kontributet e paguara nga sigurimi pensional me financim kapital, dhe ende janë në fazë të hershme të zhvillimit dhe ofertës së pakove të shërbimeve në fushën e sigurimit shëndetësor vullnetar. Kjo lidhet edhe me rezultatet e matjes së parë kombëtare të nivelit të edukimit financiar tek popullata e rritur në Maqedoni, e kryer në shkurt të vitit 2018<sup>9</sup>. Gjithashtu, kjo tregoi një nivel agregat të edukimit financiar prej 11.8, sipas metodologjisë standarde të INFE. Pra, është një nivel relativisht më i ulët në krahasim me mesataren e vendeve më të zhvilluara të botës nga grupi 20 prej 12.7 pikësh, por nga ana tjetër është i krahasueshëm me vendet e rajonit.

Anketa nxjerr në pah aspekte shtesë që lidhen me ndërgjegjësimin e popullatës për produktet individuale financiare dhe përdorimin e tyre aktual në praktikë. Sipas anketës, popullata e rritur ka një nivel solid të ndërgjegjësimit për produktet klasike bankare, ndërsa niveli i ndërgjegjësimit për produktet e sigurimit është më i ulët. Njohuri të tilla tregojnë nevojën për një informim më të mirë të popullatës në lidhje me avantazhet, por edhe rreziqet e sigurimit.

Kjo padyshim që ndikon që të kemi një volum të pakrahasueshëm më të ulët të primeve vjetore në këto produkte krahasuar me të njëjtat në tregjet e zhvilluara të sigurimeve.

**Tabela nr. 1:** Treguesit më të rëndësishëm për vendet e Europës Qendrore dhe Lindore në vitin 2022

	PBB, çmime aktuale (miliarda euro)	PBB për banor, çmime aktuale (euro)	Primi i shkruar bruto (milionë euro)	Norma e penetrimit (% në PBB)	Norma e dendësisë (Euro/banor)
<b>Shqipëria</b>	18,16	6.334	184	1,01%	64
<b>Bosnja dhe Hercegovina</b>	24,18	6.963	450	1,86%	130
<b>Bullgaria</b>	84,56	12.439	1.847	2,18%	272

<sup>9</sup> Matja e parë u organizua nga Banka Popullore, me mbështetjen e EFSE, sipas metodologjisë ndërkombëtare të INFE OECD.

Kroacia	67,39	17.485	1.682	2,50%	437
Çekia	281,27	26.745	8.297	2,95%	789
Estonia	36,18	27.167	551	1,52%	414
Hungaria	155,60	15.996	3.568	2,29%	367
Kosova	8,92	5.039	134	1,50%	76
Letonia	40,07	21.205	995	2,48%	527
Lituania	66,92	23.756	1.234	1,84%	438
<b>Maqedonia</b>	<b>13,00</b>	<b>6.284</b>	<b>208</b>	<b>1,60%</b>	<b>100</b>
Mali i Zi	5,79	9.310	108	1,87%	174
Polonia	654,11	17.372	15.429	2,36%	410
Rumania	285,49	14.993	3.337	1,17%	175
Serbia	60,44	8.831	1.142	1,89%	167
Slllovakia	107,73	19.822	1.925	1,79%	354
Slllovenia	58,99	27.994	2.799	4,72%	1.328
<b>Europa Qendrore dhe Lindore - Gjithsej/Mesatare (2021)</b>	<b>1.968,80</b>	<b>14.235</b>	<b>43.890</b>	<b>2,32%</b>	<b>486</b>

Burimi: XPRIMM, Raporti vjetor për vitin 2022

Nga 17 shtete në Europën Qendrore dhe Lindore sipas treguesit të shkallës së penetrimit, Maqedonia gjendet në vendin e 13-të sipas zhvillimit të tregut të sigurimit (para Shqipërisë, Kosovës, Rumanisë dhe Estonisë), ndërsa sipas treguesit të shkallës së dendësisë në vendin e 15-të (para Shqipërisë dhe Kosovës).

## 4. TREGU I SIGURIMEVE NE REPUBLIKËN E MAQEDONISË SE VERIUT

### 4.1. SHOQËRITË E SIGURIMEVE

Tregut të sigurimeve iu shtuan, në fund të vitit, edhe dy shoqëri të reja sigurimesh, njëra prej të cilave filloi të funksionojë në vitin 2023 dhe tjetra në 2024. Kështu, të dhënat për strukturën e pronësisë dhe gjithsej asetet me datë 31.12.2023 të publikuara në këtë raport i referohen gjithsej 18 shoqërive të sigurimit aksionar, prej tyre 6 shoqëri të sigurimit janë të licencuara për sigurime të jetës, ndërsa 12 të tjera janë për sigurime jo-jetës. Vetëm një shoqëri, përveç sigurimit të jo-jetës, ka licencë për të kryer dhe risigurim.

Shoqëritë e sigurimeve në fund të vitit 2023 punësojnë 1,933 që është afërsisht e njëjtë me situatën në fund të vitit të kaluar, 2022 (2022: 1,926).

#### 4.1.1. Struktura e pronësisë

Ndryshimet në strukturën e pronësisë janë për faktin se në fund të vitit 2023 u morën parasysh dy shoqëritë e reja të sigurimit, pra themeluesit e tyre. Megjithatë, shoqëritë e sigurimeve janë ende në pronësi kryesisht të subjekteve juridike të huaja të sektorit financiar (68.34%), të cilat janë pjesërisht ose plotësisht të pranishme në 15 nga gjithsej 18 shoqëri sigurimesh në treg (tabela nr. 2). Gjithashtu, 13 shoqëri sigurimesh janë pjesë e grupeve të sigurimit me bazë në shtetet anëtare të BE-së, ndërsa tre shoqëri sigurimesh janë në pronësi të plotë të investitorëve vendas.

**Tabela nr. 2:** Struktura e pronësisë së shoqërive të sigurimeve (për qindje)

	2022	2023
<b>1. Aksionerë të huaj</b>	<b>77,14%</b>	<b>71,39%</b>
1.1. Persona fizikë	0,50%	0,42%
1.2. Persona juridikë jofinanciarë	3,11%	2,63%
1.3. Institucione financiare	73,53%	68,34%
<b>2. Aksionerë vendas</b>	<b>22,83%</b>	<b>28,58%</b>
2.1. Persona fizikë	4,11%	6,24%
2.2. Persona juridikë jofinanciarë	0,52%	0,43%
2.3. Institucione financiare	18,20%	21,91%
<b>3. Shteti</b>	<b>0,03%</b>	<b>0,03%</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>100,00%</b>	<b>100,00%</b>


Burimi: AMS

#### 4.1.2. Shkalla e zhvillimit

Treguesit themelorë me të cilët matet shkalla e zhvillimit të tregut të sigurimeve janë norma e penetrimit/depërtimit dhe norma e dendësisë<sup>10</sup>. Të dhënat për nivelin e penetrimit të sigurimeve në vitin 2023 tregojnë se PShB-ja e përgjithshme në vend merr pjesë me 1.71% në prodhimin e brendshëm bruto, që është për 0,17% më shumë se viti i kaluar (2022: 1.54%). Ndërsa, norma e dendësisë për vitin 2023 është 6.878 denarë për banor që shënon rritje prej 12% në raport me vitin e kaluar (Grafiku nr. 1).

<sup>10</sup>Norma e penetrimit llogaritet si raport i primit të shkruar bruto dhe prodhimit bruto vendor, kurse norma e dendësisë llogaritet si raport i primit të shkruar bruto dhe numrit të banorëve në vend.

**Grafiku nr. 1:** Treguesit e zhvillimit të tregut të sigurimeve (milionë denarë; boshti i djathtë – përqindja)



Burimi: Ministria e Financave, Enti Shtetëror i Statistikës, AMS

Sektori i sigurimeve karakterizohet me përqendrim të ulët i cili është parakusht për konkurrencën funksionale të tregut. Indeksi Herfindal, i llogaritur përmes PShB-së, në vitin 2023 është 725.03 (2022: 738.09). Një rezultat i ngjashëm tregon matjen e indeksit përmes aktiveve të shoqërive të sigurimit në 751.12 në vitin 2023 (2022: 786,98)<sup>11</sup>.

Analizuar sipas grupeve të sigurimeve, përqendrim më i lartë është i pranishëm në sigurimet e jetës, për shkak të numrit të vogël të shoqërive në këtë fushë. Tek shoqëritë e sigurimeve të jetës indeksi Herfindal, i matur sipas PShB-së, 2.151,15 (2022: 2.216,13), ndërsa i matur sipas fondeve/aseteve të shoqërisë, është 2.609,28 (2022: 2.848,08).

Në sigurimin jo-jetë treguesit tregojnë përqendrim të ulët, me ç'rast matja përmes indeksit Herfindal sipas PShB-së në vitin 2023 është 966,53 (2022: 988,50), ndërsa i njëjti tregues i matur sipas fondeve/aseteve është 966,51 (2022: 976,59).

Treguesi CR5<sup>12</sup>, i matur përmes pjesëmarrjes në PShB, te shoqëritë e sigurimeve jo-jetë, në vitin 2023 pati rënie të butë me 55,12% (2022: 55,72%).

Në vijim janë tabelat që tregojnë lëvizjet e indeksit Herfindal dhe treguesit e përqendrimit të pesë shoqërive të para të sigurimeve (CR5):

<sup>11</sup>Indeksi Herfindal llogaritet sipas formulës:

$$HI = \sum_{i=1}^n (S)_i^2$$

ku S është pjesa e secilës shoqëri të sigurimeve në totalin e aktiveve (primi i shkruar bruto) i sektorit të sigurimeve, dhe n është numri i përgjithshëm i institucioneve në segmentin përkatës. Kur indeksi lëviz në intervalin prej 1,000 njësive në 1,800 njësi, niveli i përqendrimit të sektorit të sigurimeve konsiderohet i pranueshëm.

<sup>12</sup>Treguesi CR5 përfaqëson pjesëmarrjen e 5 kompanive të para të sigurimit me pjesëmarrjen më të madhe në strukturën totale.

**Tabela nr. 3:** Indeksi Herfindal dhe treguesi CR5 i matur sipas PShB-së

PShB	2022		2023	
	Herfindal	CR5	Herfindal	CR5
I gjithë sektori	738,09	45,80%	725,03	45,56%
Jo-jetë	988,50	55,72%	966,53	55,12%
Jetë	2.216,13	100,00%	2.151,15	100,00%


Burimi: AMS

**Tabela nr. 4:** Indeksi Herfindal dhe treguesi CR5 i matur sipas asetëve

Asetet/aktiva	2022		2023	
	Herfindal	CR5	Herfindal	CR5
I gjithë sektori	786,90	50,23%	751,12	48,64%
Jo-jetë	976,59	56,10%	966,51	55,65%
Jetë	2.848,08	100,00%	2.609,28	98,09%

Burimi: AMS

Në fund të vitit 2023, në fushën e përqendrimit të tregut në pjesën e sigurimeve jo-jetë, 4 shoqëri të sigurimeve e kalojnë pragun e pjesëmarrjes me mbi 10% në totalin e PShB-së. Kështu që, në tregun e sigurimeve asnjë shoqëri nuk e kalon pragun mbi 15% të pjesëmarrjes në treg (Grafiku nr. 2).


**Grafiku nr. 2:** Përqendrimi i tregut sipas Primit të Shkruar Bruto në vitin 2023, në grupin e sigurimeve jo-jetë (përqindje)

Burimi: AMS

Në grupin e sigurimeve të jetës vazhdon rritja e konkurrencës dhe tendenca rënëse e pjesëmarrjes së dy shoqërive të sigurimit të jetës që janë prezente në treg për një kohë të gjatë (grafiku nr. 3).

**Grafiku nr. 3:** Përqendrimi i tregut sipas Primit të Shkruar Bruto në vitin 2023, në grupin e sigurimeve të jetës (përqindje)





Burimi: AMS

#### 4.1.3. Primi i Shkruar Bruto (PShB)

Në segmentin e sigurimeve të jo-jetës, pjesëmarrjen më të madhe e zënë provigjonet për dëmet dhe provigjonet për primet e transferuara, kurse në sigurimet e jetës provigjoni matematikor zë vendin më të rëndësishëm.<sup>15</sup>

#### 4.1.8. Fondet që i mbulojnë provigjonet teknike


Fondet që mbulojnë provigjonet teknike janë ato fonde të shoqërisë së sigurimit që shërbejnë për të mbuluar detyrimet e ardhshme që burojnë nga kontratat e sigurimit, si dhe për të mbuluar humbjet e mundshme në lidhje me ato rreziqe që lidhen me ushtrimin e aktivitetit të sigurimeve, për të cilat shoqëria e sigurimeve është e detyruar të ndajë fonde për të mbuluar provigjonet teknike neto. Shoqëria e sigurimeve është e detyruar të investojë fonde në një vlerë të paktën të barabartë me vlerën e provigjoneve teknike neto nga risigurimi, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbikëqyrjen e Sigurimeve dhe në përputhje me Rregulloren për llojet dhe karakteristikat e fondeve që mbulojnë provigjonet teknike dhe fondet që mbulojnë provigjoni matematikor, si dhe vendosjen dhe kufizimin e detajuar të atyre investimeve dhe vlerësimin e tyre ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 64/11, 127/14, 61/16, 36/19, 107/20 dhe 118/22).

Investimet e mjeteve që i mbulojnë rezervat teknike të shoqëritë e sigurimeve jo-jetë, në fund të vitit 2023 janë në vlerë prej 10.968.344 mijë denarë dhe mbulojnë 116% të rezervave të përgjithshme neto teknike (31.12.2022: 9.996.370 mijë denarë). Është ruajtur trendi i rritjes së rezervave teknike neto, por edhe i investimeve në kategori instrumentesh të cilat, sipas ligjit, janë mbulim i pranueshëm i rezervave teknike.

---

<sup>15</sup> Më shumë të dhëna për strukturën e rezervave teknike bruto sipas kategorive individuale të sigurimit janë paraqitur në faqen e internetit të AMS: <https://aso.mk/izveshtaj-za-rabotenjeto-na-drushtvata-za-osiguruvanje-vo-periodot-1-1-2023-31-12-2023-godina/> në tabelat përkatëse nga formularët e përmbledhur për periudhën 1.1.2023 – 31.12.2023. Raporti i Stabilitetit Financiar 2022.


**Grafiku nr. 11:** Mbulimi i provigjoneve teknike neto te shoqëritë e sigurimit jo-jetë (miliona denarë; boshti i djathtë - përqindje)



Burimi: AMS.

Tek shoqëritë e sigurimit të jetës, investimet e fondeve nga rezervat teknike dhe nga rezervat matematikore arritën në 8,771.979 mijë denarë (31.12.2022: 8.332.240 mijë denarë) dhe kanë mbulim të rezervave teknike neto prej 104%. Edhe në këtë segment është ruajtur trendi pozitiv i rritjes së rezervave teknike neto (kryesisht i përbërë nga rezerva matematikore sipas kontratave të sigurimit të jetës), si dhe investimeve në kategori të pranueshme të instrumenteve financiare të fondeve që mbulojnë rezervat teknike.

**Grafiku nr. 12:** Mbulimi i rezervave teknike neto te shoqëritë e sigurimit të jetës (miliona denarë; boshti i djathtë – përqindje)




Burimi: AMS

#### 4.1.9. Përshtatshmëria e kapitalit të shoqërive të sigurimit

Në përputhje me nenet 75 dhe 76 të Ligjit për Mbikëqyrje të Sigurimeve, shoqëritë e sigurimeve duhet ta ruajnë vlerën e kapitalit në madhësinë e nivelit të nevojshëm të aftësisë paguese, përkatësisht vlerën e nevojshme të fondit garantues. Sipas të dhënave të dorëzuara në AMS, në fund të vitit 2023, kapitali i llogaritur i përgjithshëm i shoqërive të sigurimeve<sup>16</sup> kap vlerën prej 8.320.949 mijë denarë (31.12.2022: 7.241.199 mijë denarë. Në llogaritjen e kapitalit më 31.12.2023 nuk përfshihen fitimet e realizuara në vitin 2023. Duke e analizuar sipas grupeve të sigurimit, kapitali i shoqërive për sigurim jo-jetë është 5.990.473 mijë denarë (31.12.2022: 5.246.946 mijë denarë), dhe shoqërive të sigurimit të jetës 2.330.476 mijë denarë (31.12.2022: 1.994.254 mijë denarë).

Niveli i nevojshëm i marginës së aftësisë paguese, si tregues kryesor për kapitalin minimal me të cilin duhet doemos të disponojë sektori i sigurimit, i agreguar është 2,275 mijë denarë (për sigurimin jo-jetë 1.661,639 mijë denarë, ndërsa për sigurimin e jetës 613,329 mijë denarë), me çka kapitali i sektorit të sigurimit është 3,66 herë mbi nivelin e nevojshëm të marginës së rentabilitetit (aftësisë paguese). Lëvizja e kapitalit dhe margjina e nevojshme e rentabilitetit të shoqëritë e sigurimit janë paraqitur në grafikun nr. 13.

**Grafikui nr. 13:** Lëvizja e kapitalit dhe margjina e nevojshme e aftësisë paguese të shoqëritë e sigurimit (milionë denarë)




Burimi: AMS

Struktura e burimeve të kapitalit të shoqërive të sigurimit dominohet nga kapitali bazë. Pra, ai buron nga kategoritë më cilësore të burimeve të fondeve: nga kapitali aksionar i paguar nga aksionet e zakonshme të emetuara; rezervat ligjore (statutore); si dhe fitimet e pashpërndara të akumuluar. Pjesa e kapitalit shtesë në totalin e kapitalit të sektorit të sigurimeve është e tepër e vogël. Kjo krijon besim se gjendja financiare dhe aftësia paguese e sektorit të sigurimeve është e mirë.

<sup>16</sup> Rregullorja e llojeve dhe përshkrimit të paragrafëve që do të merren parasysh gjatë llogaritjeve të kapitalit të shoqërisë: për sigurime dhe/ose risigurimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 5/11, 64/11, 61/16 dhe 170/19 dhe 96/20")

**Grafiku nr. 14:** Struktura e kapitalit të shoqërive të sigurimeve (veçmas për jo-jetë dhe jetë), në miliona denarë dhe në përqindje të kapitalit total



Burimi: AMS

#### 4.1.10. Rezultati financiar nga ushtrimi i veprimtarisë

Shoqëritë e sigurimeve shënojnë rezultate solide të veprimtarisë në vitin 2023.

Krahasuar me vitin e kaluar, në vitin afarist 2023, sektori i sigurimeve ka shënuar rezultate dukshëm më të mira financiare, në të dy segmentet e tregut. Fitimi total i agreguar pas tatimit, në nivel sektori, në vitin 2023 arrin në 671,558 mijë denarë. Për krahasim, për vitin 2022 ishte 531,128 mijë denarë (grafiku nr. 15).

Rezultati i përgjithshëm i shoqërive të sigurimit të jo-jetës është pozitiv dhe arrin në 420.548 mijë denarë, për dallim nga viti paraprak, 2022, kur ishte 307.222 mijë denarë.

Rritja e vëllimit të operacioneve të shoqërive të sigurimit të jo-jetës, e shprehur përmes rritjes së primit të shkruar bruto, është arsyeja kryesore e përmirësimit të ndjeshëm të profitabilitetit në sektorin e sigurimeve të jo-jetës në vitin 2023 krahasuar me një vit më parë, 2022. Shuma totale vjetore e dëmeve të shkaktuara është rritur lehtë, ndërkohë që një rritje relative vjetore më e ndjeshme është shënuar në anën e kostove operative, administrative dhe të blerjes.

Të ardhurat totale nga primet, neto nga risigurimet, në vitin 2023 në segmentin e sigurimit të jo-jetës arrijnë në 8.652.510 mijë denarë (2022: 7.641.793 mijë denarë).

Vlera e përgjithshme e dëmeve të bëra, pa risigurim, në vitin 2023 arrin në 4,321,597 mijë denarë (2022: 4,069,465 mijë denarë); ndërsa, nga ana tjetër, vlera e përgjithshme e shpenzimeve operative, e reduktuar me komisione nga risiguresit, 4,254,843 mijë denarë (2022: 3,560,785 mijë denarë).

Kthimi nga investimet i llogaritur si diferencë ndërmjet të hyrave dhe shpenzimeve nga investimet nga pasqyra e përmbledhur e të ardhurave për vitin 2023 të shoqërive të sigurimit të jo-jetës arrin në 365.061 mijë denarë (2022: 338.988 mijë denarë).

Në segmentin e sigurimeve të jetës, ka pasur edhe përmirësim të profitabilitetit, analizuar në nivelin e pasqyrës së të ardhurave të përmbledhura.


Tek sigurimi i jetës, arsyeja kryesore e përmirësimit të profitabilitetit të përgjithshëm në vitin 2023 krahasuar me vitin 2022 është kthimi dukshëm më i mirë i arritur nga investimet, në kushtet e rritjes së kostove për shkak të rreziqeve të shkaktuara dhe kostove operative, rritja e të cilave është më e madhe se rritja në të ardhurat nga primet.

Të hyrat e përgjithshme nga primet, neto nga risigurimet, në vitin 2023 në segmentin e sigurimit të jetës janë 2,422,941 mijë denarë (2022: 2,204,867 mijë denarë).

Vlera e përgjithshme e dëmeve të shkaktuara, pa risigurim, në vitin 2023 arrin në 1,847,973 mijë denarë (2022: 1,491,998 mijë denarë); ndërsa, nga ana tjetër, vlera totale e shpenzimeve operative, e reduktuar me komisione nga risiguruesit, 761,521 mijë denarë (2022: 696,762 mijë denarë).

Kthimi nga investimet i llogaritur si diferencë ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve nga investimet nga pasqyra e përmbledhur e të ardhurave për vitin 2023 të shoqërive të sigurimit të jetës arrin në 535,223 mijë denarë (2022: 235,685 mijë denarë).

**Grafiku nr. 15:** Rezultati financiar nga veprimtaria e shoqërive të sigurimeve në (miliona denarë)



Burimi: AMS

#### 4.1.11. Rreziqet e sektorit të sigurimeve

Ashtu si një vit më parë, në vitin 2023 ekonomia u përball me pasojat e konflikteve dhe pasigurive globale, të cilat u manifestuan kryesisht nga norma jashtëzakonisht të larta inflacioni, mbi të gjitha në energjinë dhe produktet ushqimore.

Shoqëritë e sigurimeve e identifikuan rrezikun e rritjes së kostove të shkaktuara nga rritja e inflacionit dhe kanë rregulluar tarifat e tyre të sigurimit në përputhje me rrethanat dhe në kohë të duhur.

Kështu që, rritja e çmimeve dhe e kostove është amortizuar nga rritja e vëllimit të shitjeve dhe të ardhurave të realizuara.



Duke pasur parasysh strukturën e thjeshtë të modeleve të krijuara të biznesit, produkteve të sigurimit, kanaleve të shpërndarjes dhe shpërndarjes territoriale të të siguruave dhe rreziqeve të siguruara, mund të thuhet se rreziqet kryesore ndaj profitabilitetit dhe aftësisë paguese të shoqërive të sigurimit janë të qenësishme në natyrën e tyre.

Konkretisht, ato lidhen me pjesëmarrjen e lartë të kostove operative, mbi të gjitha komisionet/provizionet në rritje, por edhe konkurrencën në procedurat e tenderit që krijojnë presion për uljen e primeve në segmentin e sigurimeve të jo-jetës, të cilat përfaqësojnë mbi 82% të primit të përgjithshëm të sigurimit.

Një pjesë e konsiderueshme e rreziqeve që mund të sigurohen akoma mbeten të pasiguruara. Kjo vlen veçanërisht për rreziqet që lidhen me fatkeqësitë e motit, të cilat ekspertët i lidhin gjithnjë e më shpesh me efektet negative të ndryshimeve klimatike globale. Shoqëritë e sigurimeve janë shumë të kujdesshme në përcaktimin e kushteve të sigurimit dhe shpeshherë numri i madh i kufizimeve dhe përjashtimeve në fakt ndikon që ata që janë të siguruar të mos jenë të siguruar, gjegjësisht të mos jenë të siguruar mjaftueshëm nga rreziqet ndaj të cilave janë të ekspozuar dhe nga të cilat dëshirojnë të jenë të siguruar.

Sektori i sigurimeve të brendshme tradicionalisht zbaton një strategji investimi konservatore me pjesëmarrjen kryesore të investimeve në letrat me vlerë të qeverisë vendase dhe depozitat bankare. Ekspozimi ndaj tregjeve financiare ndërkombëtare është shumë i ulët për shoqëritë e sigurimit të jo-jetës, dhe shoqëritë e sigurimit të jetës nuk kanë pothuajse asnjë investim në instrumente financiare të huaja. Kjo strukturë investimi kontribuon në stabilitetin e sektorit, pasi siguron mbrojtje ndaj rreziqeve që lidhen me paqëndrueshmërinë në tregjet financiare. Përqendrimi i lartë i investimeve në obligacionet shtetërore, dhe vlerësimi i tyre me vlerën e drejtë (të tregut), ndikon në rezultatin e përgjithshëm financiar të shoqërive të sigurimit, në kushtet e rritjes së luhatshmërisë së normave të interesit me të cilat emetohen këto instrumente.

Në segmentin e sigurimit të jetës, ka ndryshime të rëndësishme në strukturën e portofolit të sigurimit. Në ndryshim nga vitet e shfaqjes dhe rritjes vjetore dyshifrore të sigurimit të jetës, në të cilat vite ka pasur jashtëzakonisht të ashtuquajturat sigurime të përziera që mbulojnë rrezikun e vdekjes dhe mbijetesën dhe zakonisht sjellin një kthim të garantuar për të siguarin në fund të vitit. Gjatë afatit të policës, shoqëritë e sigurimit të jetës ndryshuan politikat e tyre të biznesit, pas së cilës këto sigurime u bënë më pak të favorshme për të siguarit dhe më pak të kërkuara. Interesi i shprehur fuqishëm i bankave për t'u paraqitur në shpërndarjen e sigurimeve si përfaqësues të shoqërive të sigurimit, por edhe si përfitues të sigurimeve të jetës në rast të humbjes së jetës së kredimarrësit, ka ndikuar në një tendencë të theksuar rritjeje të të ashtuquajturit sigurim i rrezikut, që ofron mbulim sigurimi vetëm në rast të humbjes së jetës së të siguarit, por nuk parashikojnë rimbursim të fondeve të paguara në përfundim të sigurimit. Rritje regjistrohet edhe nga të ashtuquajturat sigurime unit-linked të jetës me investimet në fondet e investimeve ku i siguarit merr përsipër rrezikun e investimeve. Këto produkte nuk kanë ndonjë ndikim të rëndësishëm në aftësinë paguese të shoqërive të sigurimit, sepse shoqëritë e sigurimit marrin përsipër një rrezik dukshëm më të ulët në krahasim me të ashtuquajturat sigurime të përziera të jetës kur rreziku i tregut përballohet nga siguruesit.

Në produktet e përmendura të sigurimit, një pjesë e konsiderueshme e primeve të paguara përdoret për pagesën e shpenzimeve rrjedhëse nga shoqëritë e sigurimit. Prandaj, është e dëshirueshme që këto produkte të ofrohen në mënyrë transparente dhe të kuptueshme në mënyrë që të siguarit potencial të marrin vendime të arsyeshme për fondet e investuara, të cilat do të rrisnin besimin në sigurime dhe do të mundësonin rritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të tregut.

#### 4.1.12. Treguesit e sektorit të sigurimeve

Më poshtë është ofruar një analizë e shkurtër e treguesve kryesorë të përdorur në biznesin e sigurimeve për monitorim dhe krahasim më të mirë.

**Koeficienti i dëmeve** llogaritet si raport midis dëmeve të ndodhura në këtë periudhë dhe primit, **kurse koeficienti i shpenzimeve** paraqet raportin midis shpenzimeve për realizimin e sigurimit dhe primit. Mbledhja e këtyre dy koeficienteve e jep **koeficientin e kombinuar**. Më hollësisht, sipas grupeve të sigurimit në tabelën nr. 20 janë dhënë koeficientet me bazë bruto dhe bazë neto, përkatësisht pas izolimit të efektit të risigurimit.

**Tabela nr. 20:** Koeficientët teknik

	2023			2022		
	Koeficienti i dëmit	Koeficienti i shpenzimeve	Koeficienti i kombinuar	Koeficienti i dëmit	Koeficienti i shpenzimeve	Koeficienti i kombinuar
<b>Koeficientët neto</b>						
Jo-jetë	49,95%	49,17%	99,12%	53,25%	46,60%	99,85%
Jetë	76,27%	31,43%	107,70%	67,67%	31,60%	99,27%
Gjithsej	55,70%	45,29%	101,00%	56,48%	43,24%	99,72%
<b>Koeficientët bruto</b>						
Jo-jetë	49,20%	43,60%	92,81%	46,18%	41,76%	87,94%
Jetë	75,51%	31,19%	106,70%	67,23%	31,23%	98,46%
Gjithsej	54,02%	41,33%	95,35%	50,13%	39,79%	89,91%

*Burimi: AMS*

**Risigurimi** luan një rol të rëndësishëm në menaxhimin e rreziqeve të marrë përsipër në sigurim. Treguesit financiarë sugjerojnë se shoqëritë e sigurimeve që ushtrojnë aktivitete të grupit të sigurimeve jo-jetë bartin rrezik të konsiderueshëm në risigurim, për dallim nga shoqëritë që ushtrojnë aktivitete të sigurimit të jetës. Kjo është e dukshme edhe nga tabela e sipërme në të cilën janë paraqitur koeficientet teknike bruto dhe neto nga risigurimi, veçmas për jo-jetë dhe jetë.

Nëse analizohen të dhënat nga formularët statistikorë të përmbledhur vjetor<sup>17</sup> të publikuar, të cilat tregojnë strukturën e të ardhurave dhe shpenzimeve nga operacionet teknike sipas kategorive të veçanta të sigurimit, mund të hidhet një dritë shtesë mbi natyrën e shpenzimeve operative dhe shpenzimet që lidhen me dëmet e shkaktuara që ndikojnë në koeficientët teknikë vjetorë, por edhe në tendencat e tregut. Vëmendje të veçantë meritojnë treguesit e shprehur si shuma absolute, por edhe tregues relativë për të ardhurat dhe shpenzimet e realizuara në klasën e sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësisë automobilistike. Kjo klasë ka tarifë të rregulluar të primeve dhe është publikuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nr. 191/18.

Pasqyra e përmbledhur e të ardhurave të shoqërive të sigurimit të jo-jetës për vitin 2023, njëlloj si një vit më parë, tregon se pjesëmarrja e të ardhurave bazë vjetore të shoqërive, nga primet bruto, të transferuara në risigurime është rreth 22% (2022: 22%) ose në shumë absolute, shoqëritë kanë

<sup>17</sup> <https://aso.mk/izveshtaj-za-rabotenjeto-na-drushtvata-za-osiguruvanje-vo-periodot-1-1-2023-31-12-2023-godina/>

transferuar 2,434,384 mijë denarë (2022: 2,195,181 mijë denarë) nga të ardhurat bruto të primit në vlerë prej 11,086,894 mijë denarë (2022: 9,836,974 mijë denarë), në risigurim. Analizuar sipas shoqërive individuale, ka diferenca të mëdha në pjesëmarrjen relative të risigurimeve në të ardhurat bruto të realizuara nga primit, kështu që në raste ekstreme kjo përqindje në totalin e të ardhurave vjetore nga primit është ndërmjet 5.8% dhe 53.3%. Kësaj i përgjigjet pjesëmarrja e risigurimeve në kostot e shoqërive, përkatësisht ato në bazë të kompensimit të dëmeve dhe shpenzimeve operative. Kompensimi i përgjithshëm vjetor i risiguresve në dëme në shoqëritë e sigurimit jojetësor në vitin 2023 është 1,133,632 mijë denarë (2022: 473,081 mijë denarë), që paraqet 20,8% (2022: 10,4%) nga kompensimi bruto i realizuar nga dëmet në vit, përkatësisht nga gjithsej dëme prej 5.455.229 mijë denarë (2022: 4.542.546 mijë denarë). Të hyrat e përgjithshme vjetore nga komisionet e shoqërive të sigurimit të jo-jetës arrijnë në 579,333 mijë denarë (2022: 547,072 mijë denarë), që përfaqëson 23,4% (2022: 24,7%) të primeve të paguara nga shoqëritë ndaj risiguresve. Efekti neto financiar i risigurimit në pasqyrën e përmbledhur të të ardhurave për vitin 2022 është negativ dhe arrin në 721,419 mijë denarë (2022: 1,175,028 mijë denarë).

Nëse analizohet pjesëmarrja e risigurimeve në totalin e provigjoneve teknike bruto përmes bilancit të përmbledhur të shoqërive të sigurimit të jo-jetës, më datë 31.12.2023 vlera totale e provigjoneve teknike të transferuara në risigurim arrin në 2,013,071 mijë denarë (31.12.2022: 1,790 mijë denarë), që paraqet 17,5% (2022: 17,3%) nga vlera bruto e provigjoneve teknike, e cila arrin në 11,478,223 mijë denarë (31.12.2022: 10,424,013 mijë denarë).

**Norma e kthimit të investimeve (ROI)** llogaritet si raport i të ardhurave të zvogëluara me koston e investimit dhe vlerën e investimit. Norma e kthimit nga investimet në nivel industrie për vitin 2023 është 4,1% dhe tregon rritje krahasuar me vitin e kaluar (2022: 2,85%). Veçmas, sipas grupeve të sigurimeve, konstatohet se norma e kthimit të investimeve në sigurimet e jo-jetës në vitin 2023 është 3,12% krahasuar me 3,15% të arritur në vitin 2022, ndërsa në sigurimet e jetës në vitin 2023 kjo normë është 5,22% që është një rritje krahasuar me një vit më parë kur ishte 2.52%.

**Norma e kthimit të fondeve (ROA)** llogaritet si raport i fitimit/humbjes para tatimit ndaj totalit të fondeve. Në nivel industrie ky tregues është 2.27%, që do të thotë rritje në krahasim me një vit më parë kur ishte 2.08%. Veçmas, sipas grupeve të sigurimeve, norma e kthimit të fondeve për sigurimet jo-jetë në vitin 2023 është 2.34% kundrejt 2.02% në vitin 2022, ndërsa për sigurimet e jetës në vitin 2023 është 2.16% kundrejt 2.18% në vitin 2022.

**Norma e kthimit të kapitalit (ROE)** llogaritet si raport fitim/humbje para tatimit dhe kategorisë së kapitalit dhe rezervave të bilancit të gjendjes. Në nivel industrie, ky tregues është 8.05% kundrejt 7.77% në vitin 2022. Veçmas, sipas grupeve të sigurimeve, norma e kthimit të kapitalit për sigurimet e jo-jetës në vitin 2023 është 7,04%, që është një përmirësim në krahasim me një vit më parë, 6,39%. Për sigurimet e jetës në vitin 2023 është 10,74%, që është një rënie e lehtë në krahasim me vitin 2022, kur ishte 11,5%.

**Koeficienti i borxhit** llogaritet si raport i totalit të detyrimeve ndaj totalit të fondeve. Ky koeficient tregon se sa prej fondeve financohen nga detyrimet (provigjonet teknike dhe detyrimet e tjera), pa u përfshirë kapitali dhe rezervat ligjore. Në vitin 2023, ky koeficient është 71,83%, që paraqet një rënie të lehtë në krahasim me vitin 2022, kur ishte 73,23%.

Pasqyra e të gjithë këtyre treguesve financiarë është dhënë në Tabelën nr. 21.

**Tabela nr. 21:** Treguesit financiarë

	2023				2022			
	ROI	ROA	ROE	Borxhi	ROI	ROA	ROE	Borxhi
Jo-jetë	3,12%	2,34%	7,04%	66,80%	3,15%	2,02%	6,39%	68,43%
Jetë	5,22%	2,16%	10,74%	79,91%	2,52%	2,18%	11,50%	81,06%
Gjithsej	4,10%	2,27%	8,05%	71,83%	2,85%	2,08%	7,77%	73,23%

Burimi: AMS

#### 4.2. NDËRMJETËSIMI NË SIGURIME

Roli i ndërmjetësimit në shitje ka një ndikim gjithnjë në rritje në sektorin e sigurimeve. Gjatë vitit 2023, 38.4% (2022: 38.76%) e PShB-së së realizuar është realizuar përmes shitjeve direkte nga shoqëritë e sigurimit, ndërsa 61.6% (2022: 61.24%) është realizuar përmes kanaleve indirekte të ndërmjetësimit (tabela nr. 22).

**Tabela nr. 11:** Struktura e kanaleve të shitjes së policave sipas PShB-së së realizuar (mijë denarë)

	Jo-jetë				Jetë				Gjithsej			
	2023		2022		2023		2022		2023		2022	
	PShB	%	PShB	%	PShB	%	PShB	%	PShB	%	PShB	Pjesëmarrja
Shitja e drejtpërdrejtë	4.932.346	41,60%	4.466.513	42,50%	576.549	23,17%	489.543	21,50%	5.508.896	38,40%	4.956.056	38,76%
Shoqëritë e brokerimit në sigurime	3.733.489	31,49%	3.153.068	30,00%	982.700	39,49%	911.547	40,04%	4.716.189	32,88%	4.064.615	31,79%
Shoqëritë për përfaqësim në sigurime	897.565	7,57%	808.029	7,69%	169.443	6,81%	218.633	9,60%	1.067.008	7,44%	1.026.662	8,03%
Agjencitë turistike	21.561	0,18%	21.618	0,21%	0	0,00%	0	0,00%	21.561	0,15%	21.618	0,17%
Sallon automobilash	17.811	0,15%	16.701	0,16%	0	0,00%	0	0,00%	17.811	0,12%	16.701	0,13%
Bankat	437.864	3,69%	344.238	3,28%	577.936	23,23%	476.564	20,93%	1.015.800	7,08%	820.802	6,42%
Përfaqësues	1.787.418	15,08%	1.673.495	15,92%	181.597	7,30%	180.213	7,92%	1.969.015	13,73%	1.853.708	14,50%
Kanalet e tjera të shpërndarjes	28.409	0,24%	25.265	0,24%	0	0,00%	0	0,00%	28.409	0,20%	25.265	0,20%
Gjithsej	11.856.463	100,00%	10.508.927	100,00%	2.488.225	100,00%	2.276.500	100,00%	14.344.688	100,00%	12.785.427	100,00%

Burimi: AMS

Në strukturën e kanaleve të shitjes për sigurimet e jo-jetës, pjesëmarrje më të madhe zënë shitjet direkte me 41.6%, pasuar nga shitjet nëpërmjet shoqërive të brokerimit të sigurimeve me 31.49%, shitjet nëpërmjet agentëve (persona fizikë) me 15.08%, shitjet nëpërmjet shoqërive për përfaqësim në sigurime me 7.57%, bankat me 3.69% dhe 0.57% përmes kanaleve të tjera të shpërndarjes. Ndërsa, në strukturën e kanaleve të shitjes së sigurimeve të jetës pjesëmarrje më të madhe zënë shoqëritë e brokerimit të sigurimeve me 39,49%, pasuar nga shitjet direkte me 23,17%, bankat me 23,23%, shitjet me agentë (persona fizikë) me 7,3% dhe shoqëritë e përfaqësimit në sigurime me 6.81%.

#### 4.2.1. Përfaqësimi në sigurime

Përfaqësimi në sigurime paraqet përgatitjen dhe lidhjen e kontratave të sigurimit, në emër dhe për llogari të një ose më shumë shoqërive të sigurimit, për produktet e sigurimit që nuk konkurrojnë me njëra-tjetrën. Përfaqësimi kryhet nëpërmjet përfaqësuesve në sigurime - personave fizikë, shoqërive për përfaqësim në sigurime dhe bankave që kanë marrë leje për ushtrimin e veprimtarisë së përfaqësimit në sigurime. Përmes këtyre kanaleve, në vitin 2023 është realizuar 28,25% e PShB-së (2022: 28,95%), gjegjësisht 4,051,822 mijë denarë (2022: 3,701,172 mijë denarë), që paraqet rritje prej 9,5% në krahasim me vitin paraprak.

Përfaqësimi në sigurime nëpërmjet personave fizikë kryhet në bazë të licencës së AMS-së e cila merret pas dhënies paraprake të provimit për ushtrimin e veprimtarisë për përfaqësim në sigurime. Në totalin e PShB-së përfaqësimi në sigurime nëpërmjet personave fizikë merr pjesë me 13,73% (2022: 14,5%).


Në totalin e PShB-së, shoqëritë përfaqësuese të sigurimit në vitin 2023 marrin pjesë me 1.067.008 mijë denarë ose 7,44% nga totali i ndërmjetësimit, dhe në krahasim me vitin e kaluar është shënuar rritje prej 3,93% (2022: 1.026.662 mijë denarë).

Përfaqësim në sigurime mund ta kryejë edhe banka e cila ka marrë licencë për ushtrimin e veprimtarisë së përfaqësimit në sigurime nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në bazë të pëlqimit paraprak të AMS-së. Bankat kanë marrë pjesë me 1,015,800 mijë denarë ose 7,08% në totalin e PShB-së, që paraqet rritje prej 23,76% në krahasim me vitin 2022 (2022: 820,802 mijë denarë).

Gjatë vitit 2023, janë lidhur 113,602 kontrata (polica) përmes shoqërive të përfaqësimit në sigurime (2022: 98,975), që është 14,78% më shumë se një vit më parë. Përmes bankave, në vitin 2023 janë lidhur 207,480 kontrata sigurimi (2022: 203,587), që paraqet një rritje prej 1,9% krahasuar me një vit më parë.

Shpërndarja e totalit të PShB-së sipas klasave të sigurimit, ndërsa e realizuar nga shoqëritë për përfaqësim dhe bankat është paraqitur në Grafikon nr. 16.

**Grafiku nr. 16:** Struktura e PShB-së, sipas klasave të sigurimit



Burimi: AMS

#### 4.2.2. Veprimtari brokerimi në sigurime


Ndërmjetësimi i sigurimeve përfshin ndërmjetësimin në negociimin e mbulimit të sigurimit dhe risigurimit, si dhe në realizimin e kërkesave për kompensim pas ndodhjes së ngjarjes dëmtuese të

siguruar me shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit, në emër dhe për llogari të klientëve. Nëpërmjet këtij kanali të shpërndarjes, shoqëritë e sigurimeve në vitin 2023 kanë realizuar 32,88% të PShB-së (2022: 31,79%), gjegjësisht 4,716,189 mijë denarë (2022: 4,064,615 mijë denarë), që paraqet rritje prej 16% në krahasim me vitin paraprak.

Në këtë periudhë, shoqëritë e brokerimit në sigurime kanë shitur 479,298 polica (2022: 459,839), që paraqet një rritje prej 4,23% krahasuar me një vit më parë.

Shpërndarja e totalit të PShB-së sipas klasave të sigurimit e realizuar nga shoqëritë e brokerimit në sigurime, është paraqitur në grafikun nr. 17.

**Grafiku nr. 17:** Struktura e PShB-së, sipas klasave



Burimi: AMS

### 4.3. BYROJA KOMBËTARE E SIGURIMEVE

Në përputhje me Ligjin për Sigurim të Detyruar në Transport, Byroja Kombëtare e Sigurimeve (në tekstin e mëposhtëm: "BKS") ushtron aktivitetet e parapara me marrëveshjet ndërkombëtare për sigurim të pronarëve dhe përdoruesve të mjeteve motorike nga përgjegjësia në qarkullim (kartoni i gjelbër) dhe i përfaqëson shoqëritë e sigurimeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut në organizatat dhe institucionet ndërkombëtare të sigurimeve. BKS-ja lëshon dhe shtyp kartona jeshilë ndërkombëtarë për nevojat e anëtarëve, mban evidencë statistikore dhe kryen përpunim statistikor të të dhënave statistikore të shoqërive të sigurimeve, vendos dhe mban sistem qendror për evidencën e policave dhe dëmeve nga përdorimi i mjeteve motorike.

BKS-ja është anëtare e Këshillit të Byrove në Bruksel që nga viti 1994, që ka për qëllim të lehtësojë qarkullimin rrugor ndërkombëtar të mjeteve motorike dhe atyre shoqëruese, nëpërmjet sigurimit nga përgjegjësia për dëme të shkaktuara nga persona të tretë, sipas kushteve të cilat janë përcaktuar në vendin e vizituar dhe garanton se personave të dëmtuar në rast të fatkeqësisë rrugore do t'u kompensohet dëmi i shkaktuar me përdorim të mjetit motorik me zbatim të legjislacionit kombëtar të atij vendi. Njëkohësisht, si anëtare e Këshillit, BKS-ja merr pjesë në punën e Grupit Evropian Juglindor ku marrin pjesë vendet nga rajoni.

Në fund të vitit 2023<sup>18</sup>, në BKS janë anëtare njëmbëdhjetë shoqëri sigurimesh, përkatësisht të gjitha shoqëritë për sigurim jo-jetë.

Në raportin për punën të cilin BKS-ja ia dorëzoi AMS-së, në përputhje me nenin 54, paragrafi (3) të Ligjit për Sigurim të Detyruar në Transport, është paraqitur puna financiare e BKS-së dhe puna financiare e Fondit Garantues për vitin 2023.

Fondet e përgjithshme të BKS-së më datë 31.12.2023 arrijnë në 306,126 mijë denarë, nga të cilat 176,000 mijë denarë, ose 57,49% janë depozita në banka, 94,788 mijë denarë, ose 30,96% janë të arkëtueshme, 13,9 mijë denarë ose 11,200 denarë, ose 57,49%. para të gatshme në llogaritë bankare, dhe pjesa tjetër janë fonde jo-materiale dhe materiale. Krahasuar me një vit më parë, totali i fondeve shënoi rritje prej 2.89%. Në totalin e burimeve të fondeve të BKS-së në vitin 2023, kapitali zë 62,15%, ndërsa detyrimet 37,85%. Në vitin 2023, BKS-ja ka realizuar fitim në vlerë prej 1,101 mijë denarë (2022: fitim prej 1,992 mijë denarë).

#### 4.3.1. Fondi i Garancisë i BKS-së

BKS-ja, në përputhje me nenin 58 të Ligjit për Sigurim të Detyruar në Qarkullim, formon Fond Garantues i cili shërben për pagim të:

- dëmeve të shkaktuara në territorin e Maqedonisë nga mjete motorike dhe rimorkio të panjohura dhe të pasiguruara, barka dhe anije me fuqi motorike të pasiguruara si dhe mjete fluturuese të pasiguruara;
- dëmeve të shkaktuara në territorin e Maqedonisë nga mjete të transportit të regjistruara për transport të udhëtarëve në qarkullimin publik për të cilat pronarët nuk kanë bërë kontratë sigurimi të udhëtarëve nga pasojat e fatkeqësisë – aksidentit;

---

<sup>18</sup> Në tremujorin e parë të vitit 2024, numri i anëtarëve në BKS u rrit me një shoqëri të re sigurimesh që mori licencën për të kryer veprimtari të sigurimit të jo-jetës.

- dëmeve nga sigurimet e obligueshme për të cilat personat e dëmtuar nuk mund t'i marrin pagesat për shkak të ndërprerjes së punës së shoqërisë së sigurimeve me të cilën është bërë kontrata për sigurim, ku paguhet vetëm ajo pjesë e dëmit i cili nuk është kompensuar nga masa e falimentimit të shoqërisë së sigurimeve; dhe
- dëmeve nga mjetet motorike të siguruara të cilat kanë prejardhje nga territori i Maqedonisë, për të cilat në përputhje me Marrëveshjen e Kretës dhe marrëveshjet e tjera ndërkombëtare i garanton Byroja Kombëtare e Sigurimeve.

Puna e Fondit Garantues bazohet në Ligjin për Sigurim të Detyruar në Transport si dhe në Rregulloren për formim dhe përdorim të Fondit Garantues dhe Udhëzimin për mbajtjen e evidencës dhe mënyrën e pagesës së mjeteve nga Fondi Garantues, të miratuar nga BKS-ja.

**Tabela nr. 23:** Pjesëmarrja në Fondin Garantues sipas shoqërive të sigurimit për periudhën 1.1.2023 – 31.12.2023 (në denarë)

Emri i shoqërisë së sigurimit	Totali i PShB-së për të gjitha sigurimet e obligueshme	% e pjesëmarrjes në PShB për të gjitha sigurimet e obligueshme	Pjesëmarrja në Fondin Garantues
Maqedonia	273.330.846	4,92%	9.083.615
Triglav	473.432.021	8,53%	15.733.586
Euroins	475.764.252	8,57%	15.811.093
Sava	494.289.423	8,90%	16.426.741
Viner	736.247.703	13,26%	24.467.750
Eurolink	438.863.751	7,91%	14.584.777
Grave Jo-jetë	487.731.159	8,79%	16.208.790
Unika	781.916.963	14,09%	25.985.479
Osiguritelna Polisa	508.924.362	9,17%	16.913.104
Halk Osiguruvanje	356.079.639	6,41%	11.833.609
Kroacia Jo-jetë	524.672.297	9,45%	17.436.456
<b>Gjithsej</b>	<b>5.551.252.416</b>	<b>100,00%</b>	<b>184.485.000</b>

*Burimi: Raporti i punës i BKS-së për vitin 2023*

Shoqëritë e sigurimeve të cilat ushtrojnë aktivitete të obligueshme të sigurimeve nga autopërgjegjësia janë të detyruara të paguajnë mjete në Fondin Garantues në shumë proporcionale me primin e realizuar sipas klasave të veçanta të sigurimit të obligueshëm nga autopërgjegjësia në tremujorin paraprak, për tremujorin vijues gjatë vitit aktual.

Në përputhje me vendimin e Bordit Drejtues të BKS-së çdo vit kalendarik kryhet shpërndarje e re e mjeteve të Fondit Garantues në vlerë prej 3,000,000 eurosh, sipas përqindjes së pjesëmarrjes së shoqërisë së sigurimeve në primin e përgjithshëm të shkruar për të gjitha sigurimet e obligueshme. Për vitin 2023, pjesëmarrja në Fondin Garantues sipas shoqërive të sigurimeve është dhënë në Tabelën nr. 23.

#### 4.3.2. Rimbursimi i dëmeve nga Fondi i Garancisë

Në përputhje me nenin 60, paragrafi (4) të Ligjit për Sigurime të Detyruara në Transport, shoqëria e sigurimeve që ka kryer përpilim dhe pagesë të kërkesës për kompensim të dëmit ka të drejtë të kthimit të mjeteve të paguara nga mjetet e Fondit Garantues.



Nga mjetet e Fondit Garantues nuk kompensohen dëmet e ndodhura nga përdorimi i mjeteve motorike të huaja të pasiguruara që qarkullojnë në territorin e Maqedonisë, kurse për të cilat vlejnjë marrëveshjet e veçanta ndërkombëtare në të cilat nënshkruese është Maqedonia.

**Tabela nr. 24:** Dëme të raportuara dhe të pranuar për rimbursim nga Fondit Garantues për periudhën 1.1.2023 – 31.12.2023

Emri i shoqërisë së sigurimeve	Numri i dëmeve të raportuara për rimbursim	Numri i dëmeve të pranuar nga Fondi Garantues	Dëme të pranuar nga Fondi Garantues (dëme+gjendje) vlera në denarë
Maqedonia	30	30	21.962.272
Triglav	42	42	6.276.128
Euroins	34	32	5.295.579
Sava	40	39	7.581.900
Viner	54	53	14.689.704
Eurolink	35	35	5.590.439
Grave Jo-jetë	38	38	6.306.649
Unika	49	49	10.270.756
Osiguritelna polisa	36	36	4.248.698
Halk	56	55	7.137.223
Kroacia Jo-jetë	39	38	5.838.315
<b>Gjithsej</b>	<b>453</b>	<b>447</b>	<b>95.197.663</b>

*Burimi: Raporti i punës i BKS-së për vitin 2023*

Në vitin 2023, në BKS janë raportuar 453 kërkesa për rimbursim nga shoqëritë e sigurimeve, prej të cilave 447 janë pranuar dhe rimbursuar në vlerë të përgjithshme prej 95.198 mijë denarë.

Krahasuar me një vit më parë, një tendencë rënëse është vërejtur në numrin total të dëmeve të raportuara dhe të pranuar, si dhe në vlerën totale të dëmeve të paguara.

Numri i dëmeve të paraqitura dhe të pranuar për rimbursim nga Fondi Garantues gjatë vitit 2023, si dhe vlera e dëmeve të pranuar janë dhënë në Tabelën nr. 24.

**Numri**  
**Shkup, 29.6.2023**

**Kryetari i Këshillit të Ekspertëve,**  
**Kërste Shajnoski**